



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca: 626-20-001-2-3-6

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

Operatori Ekonomik **"OK GROUP" SH.P.K.** me numër të biznesit **810975782**, selia në Prizren të cilën e përfaqëson z. Besart Kuqi, në cilësinë e Pronarit (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:

Titulli i kontratës: "HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2020" me numër Identifikues të prokurimit: **626-20-251-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj Kontrate është hartimi i projekteve ideore dhe ekzekutive për ndërtimin e rrugëve, objekteve, kanalizimeve, varrezave dhe ndriçimit publik në Mamushë sipas detyrës projektuese të dhënë në aneksin I të dosjes së tenderit për projektet si më poshtë:

Nr	Emri i objektit ndërtimor	Tipi i objektit	Njësia	Sasia
1	Projektimi i rrjetit të kanalizimit fekal	Projekt i ri	m'	3500
2	Projektimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik si dhe kanaleve të hapura	Projekt i ri	m'	3500
3	Projektimi i rrugëve	Projekt i ri	m'	2000
4	Projektimi i rrugëve fushore	Projekt i ri	m'	3000
5	Projektimi i varrezave	Projekt i ri	m ²	1200

6	Projektimi i Objektit shkollor	Projekt i ri	m ²	2100
7	Projektimi i Objektit Kulturor	Projekt i ri	m ²	1500
8	Projektimi i objekteve sportive	Projekt i ri	m ²	1300
9	Projektimi i ndriqimit	Projekt i ri	m'	3500
10	Projektimi i parqeve	Projekt i ri	m ²	2000
11	Projektimi i sistemit te ngrohjes te shkolles fillore	Projekt i ri	komplet	1
Vërejtje: Tek objektet duhet të prezantohen edhe projektet idore .				

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit të sajë nga palët kontraktuese dhe përfundon pas kryerjes së shërbimeve të parapara me planin dinamik të paraqitur nga kontraktuesi.

1.3 Afati kohor i realizimit të hartimit të projekteve nuk mund të jetë më shumë se 59 (Pesëdhjetenëntë) ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në Komunën e Mamushës dhe në byronë projektuese të kontraktuesit.

1.5 Paramasa dhe parallogaria e projekteve duhet te hartohet ne gjuhen Shqipe dhe Serbe.

1.6 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP1 (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3,660.00€;**
Tremijë e gjashtëqindë e gjashtëdhjetë Euro.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është shuma e vetme të cilën Autoriteti Kontraktues duhet t'ia paguaj Kontraktuesit në bazë të kësaj kontrate. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas kryerjes së shërbimeve nga Opertaori Ekonomik dhe pas pranimi të faturës dhe vërtetimit të kryerjes së shërbimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në aneksin nr. I të Dosjes së Tenderit.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryej shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë shërbimet e ofruara, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, për të kryer shërbimin sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse shërbimet kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

9.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente] në Prishtinë në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13**Komunikimi**

13.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet të jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.


E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Besart Kuqi	Emri:	Gazmend Gashi	
Pozita:	Pronar	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		
Data:	30.03.2020	Data:	30.03.2020	
Vula:		Vula:		



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO



MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2020”

Nr. i Prokurimit ¹	626-20-251-2-3-6
Nr i brendshëm	626-20-001-2-3-6


HARTIMI I PROJEKTEVE PËR KOMUNËN E MAMUSHËS

Çmimet të llogariten me të gjitha tatimet e aplikuar në Kosovë

Nr	Emri i objektit nderiomer	Tipi i objektit	Njësia	Çmimi në euro per njësi i projektit kryesor (zbatues) me të gjitha fazat e nevojshme	Totali €
1	Projektimi i rrjetit të kanalizimit fekal	Projekt i ri	m'	0.10	350
2	Projektimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik si dhe kanaleve të hapura	Projekt i ri	m'	0.10	350

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

3	Projektimi i rrugëve	Projekt i ri	m'	2000	0.10	200
4	Projektimi i rrugëve fushore	Projekt i ri	m'	3000	0.10	300
5	Projektimi i vorrezave	Projekt i ri	m ²	1200	0.25	300
6	Projektimi i Objektivit shkollor	Projekt i ri	m ²	2100	0.30	630
7	Projektimi i Objektivit Kulturor	Projekt i ri	m ²	1500	0.30	450
8	Projektimi i objekteve sportive	Projekt i ri	m ²	1300	0.30	390
9	Projektimi i ndriqimit	Projekt i ri	m'	3500	0.10	350
10	Projektimi i parqeve	Projekt i ri	m ²	2000	0.12	240
11	Projektimi i sistemit të ngrohjes të shkolles fillore	Projekt i ri	komplet	1	100	100
Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet						3660.00



IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	OK GROUP SH.P.K
ADRESA E PLOTE	PRIZREN
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	BESART KUQI
POZITA	PRONAR
NËNSHKRIMI	
DATA	14.02.2020
VULA	

